



**Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve ekonomikë “Sireta 2F” shpk & “Varaku E” shpk**  
**Adresa: Lagjia Babrru Fushe, Komuna Paskuqan, Tirane & Godinë private, Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30, Xhafzotaj, Durres.**

## **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Rikonstruksioni i rrugës Zall-Bastarit (Ura Zall Dajt deri në Zall Bastar) - Loti II”.**

**Numri i referencës së procedurës: REF-12802-03-07-2019**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Rikonstruksioni i rrugës Zall-Bastarit (Ura Zall Dajt deri në Zall Bastar) - Loti II”.**

**Fondi limit: 74,808,095** (shtatëdhjetë e katër milion e tetëqind e tetë mijë e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

**Kohëzgjatja e kontratës: 45** (dyzet e pesë) javë kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 26.04.2019, Ora: 10:00.**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 10 datë 11.03.2019.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “Arifaj” shpk**

**NUIS J76418907K**

Vlera e ofertës = **53,407,941** (pesëdhjetë e tre milion e katërqind e shtatë mijë e nëntëqind e dyzetë e një) lekë pa TVSH.

**2. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Sireta 2F” shpk & “Varaku E” shpk**

**NUIS K51501008J & NUIS J61902509S**

Vlera e ofertës = **55,555,555** (pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

**3. Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk**

Vlera e ofertës = **57,476,514.90** (pesëdhjetëe shtatë milion e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e katërbëdhjetë pikë nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

#### **4. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Kthella” shpk & “Ndregjoni” shpk**

NUIS J69303023D & NUIS K31329048I

Vlera e ofertës = **57,632,738** (pesëdhjetëe shtatë milion e gjashtëqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e tridhjetë e të) lekë pa TVSH.

#### **5. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Shpresa AI” shpk & “Kupa” shpk**

NUIS K31321021N & NUIS

K51615512C

Vlera e ofertës = **58,887,111** (pesëdhjetë e tetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë)lekë pa TVSH.

#### **6. Operatori ekonomik “Kola Invest” shpk**

NUIS

K93103401G

Vlera e ofertës = **58,957,836** (pesëdhjetë e tetë milion e nëtëqind epeëdhjetëe shtatë mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë)lekë pa TVSH.

#### **7. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Viante Konstruksion” shpk &”EuroAlb” shpk**

NUIS K47103804L& NUIS K66613407H

Vlera e ofertës = **59,660,424.30** (pesëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e njëzetë e katër pikë tridhjetë) lekë pa TVSH.

#### **8.Operatori ekonomik “Senka” shpk**

NUIS J76418907K

Vlera e ofertës = **62,081,681** (gjashtëdhjetë e dy milion e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

#### **9.Operatori ekonomik “Desaret Company” shpk**

NUIS J76418907K

Vlera e ofertës = **70,951,460.37** (shtatëdhjetë milion e nëntëqind e pesëdhjetëe një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë pikë tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:**

**Përkatesisht për arsyet e mëposhtme:**

#### **1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Arifaj” shpk**

NUIS

J76418907K

- Operatori ekonomik “Arifaj” shpk nuk plotëson pikën 5 të kapaciteti Teknik të Kriterëve të Vecanta të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Operatorët ekonomik*

*pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë.....1 (një) inxhinier Mjedis (i pajisur me çertifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis).....” **pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se është paraqitur dokumentacion për 2 inxhinierë mjedisi të paraqitur me Çertifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të cilët kanë kontrata pune respektivisht në datë 22.02.2019 dhe 03.04.2019 pra nuk figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 muajt e fundit. Gjithashtu është paraqitur paraqitur dokumentacion për Ekspert për vlerësimin e ndikimit në mjedis i cili nuk është Inxhinier Mjedis.***

- Operatori ekonomik “Arifaj” shpk nuk plotëson pikën 17 të kapaciteti Teknik të Kriteve të Vecanta të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10)/ Kamioncine 3,5-5 ton” pasi nga 3 kamioncina të deklaruar, kamioncina me targë AA835MU është nën kapacitetin e kërkuar 0,7 ton, për kamioncinë me targë AA901VR nuk është paraqitur Çertifikata për Transport Mallrash Brenda vendit cka bie në kundërshtim me përcaktimin e gërmës “a” të kësaj pike si dhe për kamioncinën me targë KR6923A i gjithë dokumentacioni është paraqitur fotokopje i pa njehsuar me origjinalin cka bie në kundërshtim me përcaktimin e DST: “Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”.
- Operatori ekonomik “Arifaj” shpk nuk plotëson pikën 17 të kapaciteti Teknik të Kriteve të Vecanta të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)/ Eskavator me goma/ 2 goma” **pasi nga 2 (dy) eskavator me goma të kërkuar njëri është paraqitur me faturë tatimore dhe jo me dokumentacionin e kërkuar.**

Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Arifaj” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

## **2.Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk**

NUIS K02003001O

- Operatori ekonomik ”Eurondertimi 2000” shpk nuk plotëson gërmën ”b” të pikës 2.3, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST: ” punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlere monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **149,616,190** (njëqind e dyzetë e nëntë milion e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH” pasi totali I punëve të ngjashme të paraqitura nuk plotëson vlerën e kërkuar.
- Operatori ekonomik Eurondertimi 2000 shpk nuk plotëson pikën 3, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST ku citohet se: ” *Kandidati ofertues*

*duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve.....” pasi deklarata mbi drejtuesin teknik i referohet objektit:”Sistemim dhe ndërtim i terreneve sportive në shkollën 9 vjeçare Grekan” dhe jo objektit :“Rikonstruksioni i rrugës Zall-Bastarit (Ura Zall Dajt deri në Zall Bastar) – Loti II”.*

- Operatori ekonomik Eurondertimi 2000 shpk nuk plotëson pikën 6, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se:” *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, 1 (një) mjek të përgjithshëm”,* pasi për mjeken e deklaruar ka përfunduar vlefshmëria e Urdhrit të Mjekut me datë 07.04.2014.
- Operatori ekonomik Eurondertimi 2000 shpk nuk plotëson pikën 8, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se:” *Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) Eskavatorist, 1 (një) Buldozerist, 2 (dy) Automakinist, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit”,* pasi ka deklaruar vetëm 1 punonjës eskavatorist nga 2 të kërkuar, asnjë punonjës buldozerist dhe vetëm një punonjës automakinist për të cilin nuk ka paraqitur kontratë pune nga 2 të kërkuar.
- Operatori ekonomik Eurondertimi 2000 shpk nuk plotëson pikën 16, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se:” *Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis (Kodi III.2.B)”,* pasi nuk ka paraqitur Licensën për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve që kanë ndikim në mjedis.
- Operatori ekonomik:Eurondertimi 2000 shpk nuk plotëson pikën 17, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se:” *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)”* pasi ka deklaruar se disponon 4 kamionë përkatësisht me targa TR4164S, TR4165S, AA758UE, TR1598S. Mjeti me targë TR4164S ka kapacitet mbajtës 17.7 ton dhe mjeti me targë TR4165S ka kapacitet mbajtës 17.3 ton, pra e tejkalojnë tonazhin e kërkuar.
- Operatori ekonomik:Eurondertimi 2000 shpk nuk plotëson pikën 17, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se:” *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)”* pasi janë deklaruar një autovinc me targë AA069FJ, për të cilin nuk ka paraqitur certifikatë për transport mallrash brenda vendit.
- Operatori ekonomik:Eurondertimi 2000 shpk nuk plotëson pikën 17, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se:” *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)”* pasi janë deklaruar 3 autobetoniere ku për autobetonieret me targa DR8315E dhe DR0134F, nuk është paraqitur certifikata e pronësisë dhe certifikata për transport mallrash brenda vendit. Për autobetonieren tip DIECI mungon dokumentacioni i rregullt ligjor, pasi është paraqitur vetem faturë dhe foto.
- Operatori ekonomik:Eurondertimi 2000 shpk nuk plotëson pikën 17, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se:” *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)”* pasi është deklaruar

1 autobot uji me targë AA418UC, për të cilin nuk ka paraqitur certifikatën për transport mallrash brenda vendit dhe foto.

- Operatori ekonomik:Eurondertimi 2000 shpk nuk plotëson pikën 17, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se:” *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)*” pasi janë deklaruar 2 fadroma me goma përkatësisht fadroma me targë AFMT39 dhe fadroma BOBCAT Tip JCB dhe nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar për fadromën BOBCAT Tip JCB.
- Operatori ekonomik:Eurondertimi 2000 shpk nuk plotëson pikën 17, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se:” *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)*” pasi nuk është deklaruar mjeti grejder.
- Operatori ekonomik:Eurondertimi 2000 shpk nuk plotëson pikën 17, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se:” *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)*” pasi është deklaruar 1 eskavator me goma për të cilin nuk është paraqitur dokumentacioni ligjor i kërkuar, por vetëm faturë dhe foto.

Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Eurondertimi 2000” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

### 3. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Kthella” shpk & “Ndregjoni” shpk

NUIS J69303023D & NUIS K31329048I

- Operatori ekonomik “Kthella” shpk nuk plotëson pikën 5, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se :”*Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, librezat e punës, .....: **1 (një) inxhinier Ndërtimi**”,* pasi dokumentacioni I kërkuar (diplomë dhe Librezë pune) për inxhinierët e ndërtimit është paraqitur fotokopje e pashoqëruar me vërtetimin e notrizimit cka bie në kundërshtim me përcaktimin e DST: “*Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim*”.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kthella” shpk & “Ndregjoni” shpk nuk plotëson pikën 5, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se :”*Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, librezat e punës, .... **1 (një) inxhinier Mjedisi (i pajisur me certifikatë***

**lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis)** pasi ka deklaruar 3 inxhinierë mjedisi ku dy prej të cilëve dokumentacionin i kërkuar është paraqitur fotokopje e pashoqëruar me vërtetimin e notrizimit cka bie në kundërshtim me përcaktimin e DST: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”* ndërsa për inxhinierin me iniciale B.L nuk është paraqitur Çertifikata për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kthella” shpk & “Ndregjoni” shpk nuk plotëson pikën 7 Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se :” *Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht..... **1 (një) Bulldozerist**”*, pasi nuk ka deklaruar asnjë të tillë.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Kthella” shpk & “Ndregjoni” shpk nuk plotëson pikën 17 të kapacitetit Teknik të Krieteve të Veçanta të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)/Autobetoniere”* pasi për mjetet Autobetoniere me targë TR2516M dhe TR2537M I gjithë dokumentacioni i kërkuar është paraqitur fotokopje i pashoqëruar me vërtetimin e notrizimit cka bie në kundërshtim me përcaktimin e DST: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”*, ndërsa për mjetet autobetoniere me targëAA469PU dhe AA471PU nuk është paraqitur Çertifikata për transport mallrash brenda vendit cka bie në kundërshtim me gërmën “a” të pikës 17 të Kapacitetit teknik të DST.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Kthella” shpk & “Ndregjoni” shpk nuk plotëson pikën 17 të kapacitetit Teknik të Krieteve të Veçanta të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)/Autobot Uji”* pasi nga verifikimi i dokumentacionit mjeti me targë KR7195A rezulton i montuar, kamion+bot uji.  
Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Eurondertimi 2000” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **bashkimin e operatorëve ekonomikë “Sireta 2F” shpk & “Varaku E” shpk**, me adresë: **Lagjia Babrru Fushe, Komuna Paskuqan, Tirane & Godinë private, Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30, Xhafzotaj, Durrës**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **55,555,555 (pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë** pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 09.05.2019**

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk u paraqit asnjë ankesë.